



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

T.+355-4-2281695 E. juridical@cec.org.al,
www.cec.org.al



DREJTORIA JURIDIKE

RELACION

PËR MIRATIMIN E FLETËS TIP SIPAS KËRKESËS SË INSTITUTIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E SISTEMIT TË ZGJEDHJEVE, PËR NISMËN LIGJVËNËSE TË ZGJEDHËSVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, PËR PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT "PËR REFERENDUMET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në datë 12.06.2020, Komiteti përfaqësues i nismës ligjvënëse z. Kristaq Kume, znj. Brisida Kondi dhe znj. Eneda Bozheku kanë paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën nr.1187 prot, datë 12.03.2020 për pajisje me fletë tip për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë. Bashkëlidhur kërkesës komiteti përfaqësues ka depozituar:

- Vërtetimin, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e datës 21.02.2020, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.2672, datë 22.09.1999 ka regjistruar si person juridik Fondacioni "Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve" (INSIZ) me themelues z.Kristaq Kume.
- Kopje të kartës së identiteti për të tre përfaqësuesit e nismës.

Projekt ligji është rezultat i një pune të gjatë konsultuese me ekspertë, grupe qytetarësh, të zgjedhur vendorë dhe stafe akademike në universitetet e vendin. Janë konsultuar përvojat legjislative të vendeve të ndryshme që e kanë funksionale demokracinë e drejtpërdrejtë. Në të janë pasqyruar kërkesat dhe standardet e parashikuara në dokumentet ndërkombëtare që trajtojnë çështjet e të drejtës për referendum.

Projekt ligji ka për qëllim të rregullojë, në mënyrë të detajuar, procesin dhe procedurat në bazë të të cilave duhet të ndërmerret dhe realizohen nisma për referendum. Objektiv i tij është realizimi i një ligji që do të bëjë të mundur dhe funksionale, në kushtet e shoqërisë shqiptare, demokracinë e drejtpërdrejtë. Projekt ligji rregullon procedurat që duhet të ndiqen për të iniciuar dhe realizuar referendume kushtetuese, referendume për çështje ose probleme të qeverisjes dhe vendimmarrjes qendrore ose lokale. Ai parashikon zhvillimin e referendumeve vendimmarrëse, shfuqizuese ose referendume konsultuese.

Projekt ligji parashikon mekanizma dhe procedura që e lehtësojnë dhe e bëjnë realisht të mundshme iniciativën qytetare për referendum. Është parashikuar edhe e drejta e 300000 zgjedhësve për të kërkuar zhvillim e një referendumi kushtetues.



Projekt ligji ndërton mekanizma që lehtësojnë realizimin e iniciativës së zgjedhësve për referendum të përgjithshëm. Ai parandalon vendimmarrje që paragjykojnë iniciativën.

Referendumi lokal është trajtuar si një proces i mbyllur brenda njësisë vendore përkatëse. E drejta dhe detyrat për organizimin dhe administrimin i përket qytetarëve. Organet e qeverisjes vendore mbështesin dhe lehtësojnë zhvillimin e referendumit. Gjykata administrative, nën juridiksionin e të cilës ndodhet njësi vendore, gjykon bëshmërin ligjore të referendumit dhe shqyrton ankesat. KQZ-ja vetëm mbështet dhe angazhohet për trajnimin profesional të qytetarëve që do të administrojnë procesin e referendumit.

Projekt ligji synon zvogëlim sa më të madh të ndërhyrjeve të partive politike në iniciativat qytetare për referendum.

Kërkesën e tyre përfaqësuesit e nismës ligjvënëse e bëjnë në mbështetje të nenit 6, pika 4, neni 10 pika 1 e ligjit nr.54/2019 "Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë".

Në mbështetje të nenit 10 pika 2 të ligjit nr.54/2019 "Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë", KQZ, duhet të pajis përfaqësuesit e nismës me fletën-tip, për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme. Referuar nenit 10 pika 3 të ligjit të sipërcituar, fleta-tip e mbledhjes së nënshkrimeve, në njërën duhet të përmbajë informacionin mbi nismën ligjvënëse që do të propozohet Kuvendit, qëllimin dhe një shpjegim të përmbledhur të saj si dhe të dhëna për përfaqësinë / komitetin përfaqësues të nismës ndërsa në anën tjetër duhet të përmbajë; numrin rendor, gjenealitetet e zgjedhësit që mbështet nismën, vendin e datën e lindjes, numrin e kartës së identitetit apo pasaportës së zgjedhësit, kolonën për nënshkrimet e zgjedhësve si dhe hapësirën përkatëse për emrin dhe mbiemrin e anëtarëve të grupit të mbledhjes së nënshkrimeve.

Kërkesa e komitetit përfaqësues të nismës ligjvënëse përmban, informacionin mbi nismën ligjvënëse që do të propozohet Kuvendit, qëllimin dhe shpjegimin në mënyrë të përmbledhur të saj si dhe të dhënat e komitetit përfaqësues të nismës.

Dëshira PASKO – Drejtoria Juridike

Ylli MERKAJ – Sekretar i Përgjithshëm i KQZ-së

